



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.07.2024

Nr: 100

VENDIM

PËR

EMËRIMIN E NDIHMËSIT TË AUDITIT TEKNICIEN PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile”, vendimit nr. 82, datë 15.7.2024, “Për emërimin e auditit teknicienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I M:

1. Emërimin si ndihmës të auditit teknicien z. Krenar Fortuzi, për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024.
2. Caktimin e masës së shpërblimit në vlerën 45,500(dyzet e pesë mijë e pesëqind), për ndihmësin e auditit teknicien për periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 22.07.2024 Nr:
Ora: hh:mm



“Për emërimin e ndihmësit të auditit teknicienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”